



Republika e Kosovës
RepublikaKosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, mbajtur më 16.11.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë : Amir Simnica, Arianit Beqiri, Pëllumb Bajçinovci, Sami Boroci dhe Rozafa Fetahaj.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i Komitetit z. Amir Simnica me këtë ;

R E N D TË D I T Ë S

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit;
2. Plani rregullues Kalabria;
3. Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës;
4. Të ndryshme.

Para se të fillohet me pikat e rendit të ditës për zv. kryesues të Komitetit u propozua z. Arianit Beqiri, ku dhe njëzëri për zv. kryesues të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit u zgjodh Arianit Beqiri.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

Sami Boroci –para se të fillohet me pikat e rendit të ditës të pranishmit i informoi lidhur me mos pëlqimin e tij rrëth mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit, ku në vazhdim thotë se në ekstrakt është data kur e kemi mbajt mbledhjen inauguruese me **09.08.2022**, d.m.th ka qenë fillimi i muajit gusht, sot jemi në nëntor, në gjysmën e nëntorit edhe tek tash po e mbajmë mbledhjen e parë, kemi fol edhe personalisht që nuk më ka pëlqye, kam shkruar edhe email,

Faqe 1 nga 8

sepse mendoj që këto mbledhje duhet me u mbajt pavarësisht volumit që kemi pas, duhet me u mbajt të rregullta.

Prandaj po ta jap si sugjerim mundohu që mbledhjet me i mbajt me rregull, çka do që duhet me të ndihmuar na këtu jemi të lutna mos hezito.

Amir Simnica - tha se kjo pjesë e fajit është pjesë e fajit tim sepse të kam treguar edhe personalisht që i kemi pasur disa të pa pritura, krejtësisht private, jo që kanë pas të bëjnë me Komitetin ose Asamblenë, a po me politikat ditore që i kemi na si asamblistë shpresoj dhe ju njoftoj që tash e tutje në secilin muaj do të jeni të ftuar dhe do të diskutojmë tema.

Arianit Beqiri - tha se duke i parë këto dy pikat tjera 2 dhe 3, rëndësinë e komitetit që e ka, edhe unë po pajtohem shumë me Samiun që duhet me u taku sa ma shpesh që mundemi si dhe nëse është e mundur të kemi paraprakisht materialin për të cilin kemi me diskutuar.

Mimoza Sylejmani - duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Boroci dhe Beqiri lidhur me mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit tha se unë kam qenë kryesuese e komitetit, nuk është që i kemi mbajt me rregull, por i kemi mbajt pikat që kanë qenë më të nxehtha, nuk është që na u ka bashkëngjit ndonjëherë drejtori por unë kam insistuar për me e mbajt për shkak të profesionit që kam si arkitekte.

Ajo në vazhdim tha se i kam ftuar në diskutim publik asamblistët, kur ka qenë për planin rregullues që u pat bë e madhe te fakulteti teknik, që u diskutua edhe në Kuvend pastaj, pasi që diskutimi ka ardhur edhe në Kuvend.

Arbër Sadiku, drejtori i Urbanizmit - tha se unë mendoj që ky komitet qëllimin e ka me i diskutuar na në përgjithësi politikat e këtyre dy sektorëve, edhe normalisht ato lidhen pastaj edhe me pika konkrete që minden me një moment me u lidh me Kuvendin, me rendin e ditës në Kuvend, për shkak se ne politikat i zhvillojmë përmes Kuvendit, por jo diçka që ne jemi të gatshëm për me ardhur (Mimoza e përmendi që përpara nuk kanë ardhur drejtorët, përpara nuk kanë ardhur as në Kuvend po ajo ka mbet përpara) tash po dëshirojmë me e krijuar një praktikë të mirëkuptimit, për me i nda do sende që janë për krejt me u nda, me e gjet mekanizmin qysh me i nda edhe me publikun në këtë rast përmes këshilltarëve, këshilltarët e kanë caktuar dikë për me i përfaqësuar në komitet, etj.

Amir Simnica- nëse nuk kemi diskutime tjera atëherë shkojmë në miratimin e ekstraktit të procesverbalit.

Me 4 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Plani rregullues Kalabria

Mimoza Sylejmani - tha se pas shumë takimeve që i kemi pas me banorë, kryetari e ka formuar komitetin konsultativ i cili është i përbërë prej shumë sektorëve të cilët merren me planifikim, është asociacioni i arkitektëve është ministria e kulturës e cila merret sektori i trashëgimisë që

neve na hyn në punë, është instituti për planifikim i cili është në kuadër të ministrisë për planifikim, do të thotë gjitha sektorët edhe kemi prej shoqërisë civile prej OJQ-ve që merren me planifikim, jemi munduar, ju kemi dërguar ftesa të gjithëve, po kush do që është përgjigj ne e kemi bë një grup punues i cili ka dal edhe nëpër media. Si profesionist që janë e kemi diskutuar draft dokumentin të cilin ne e kemi gjet, Samiu e din se ka qenë asamblistë 4 vjet, i cili ka dal në Kuvend pa miratimin e Ministrisë së Planifikimit, d.m.th na asgjë nuk mundemi me pru pa miratimin e kësaj ministrie.

Konsultimet i kemi bë me Institutin për Planifikim me z.Luan Nushi, i cili është pjesë edhe i komitetit konsultativ, i cili na ka sugjeruar që nuk e përjashton neni 17 i ligjit për planifikim, për këtë arsye ju kemi sjell këtë pikë të rendit të ditës për me votuar për inicim, kaq është sa i përket Kalabrisë, d.m.th kush e ka pa materialin e ka lexuar, aty është diku 355 hektar nëse nuk gaboj, u diskutua shumë është keq interpretuar shumë, dua të ju them kjo është vetëm një inicim, keni me votuar për inicim.

Arbër Sadiku - tha se unë pajtohem me atë çka i tha Mimoza, ndoshta veç me e thjeshtëzuar me dy fjali, kjo është një inicim qysh e parashevë ligji inicimin e secilit plan tëhollësishëm në bazë të ligjit, asgjë nuk ka të jashtëzakonshme, pos që po niset me një lagje të caktuar e cila është me ma prioritet për shkak ju e dini historinë e vazhdueshme që e ka pas. Çdo plan rregullativ i hollësishëm ka me ndjek këtë procedurë, sepse ligji e parashevë punën e parë me e iniciuar në Kuvend, kuvendi hartimin e planit e pastaj shkojnë procedurat tjera.

Sami Boroci - lidhur me Planin Rregullativ tha se kur është bë hartimi i planit që ka ndodhë në fillim të mandatit tuaj, nëse nuk gaboj, ju i keni premtuar banorëve që kjo ka me ardhur për 6-7 muaj, tash na këtu kemi të bëjmë me inicim, potencialisht, sa mundet me i marr hartim pastaj.

Mimoza Sylejmani - duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Boroci tha se arsyja e mos sjelljes së draft dokumentit të Planit rregullues Kalabria është se Ministria e Planifikimit, ja ka shkëput kontratën kompanisë e cila e ka punuar draftin e kaluar të planit zhvillimor komunal. Ku dhe jemi takuar me ministrin me të cilin kemi raporte mjaft të mira dhe kemi biseduar ku fatmirësish, është edhe arkitekt edhe po din me ju ec procedurave që është fat për neve. Ajo në vazhdim tha se së bashku me një grup të njerëzve kemi punuar, dhe ai draft është rregulluar. Draft dokumenti ka qenë i përbërë prej 392 faqeve, të cilin e kemi reduktuar në 322 faqe, e posedojnë të gjithë drejtoret që kanë qenë në grup punues, do të ju dorëzohet edhe juve shumë shpejt apo të dorëzohet edhe në ministri.

Ajo mes tjerash tha se Komuna e Prishtinës për herë të parë e ka instaluar një program i cili është i njobur për planifikim në krejt botën është GIS, i cili na ka ardhur nëse të kujtohet ty me u përsërit si buxhet janë kryer krejt procedurat e kemi ble licencën, i gjithë materiali e gjithë gjendja e krejt Komunës së Prishtinës, është tash në atë program edhe janë duke punuar me të madhe. Ku tani tash Komuna e Prishtinës është duke krijuar data bazë të madhe, llojet e tokave, erërat ka po vijnë, kur si kemi dit, GIS ti mundëson krejt këto, jemi duke punuar shumë ngushtë edhe me ujësjellësin rajonal që na ka ndihmuar, me Kedsin,

Arbër Sadiku - lidhur me Planin Zhvillimor Kalabria, të cilin e kemi shfuqizuar pak më parë ishte pala ku shprehi shqetësimin lidhur me shfuqizimin e planit me të cilin ka qenë e paraparë shkolla dhe çerdhja, në pjesën për të cilën e kishte marr lejen dhe ka qenë veç duke ndërtuar.

Ai në vazhdim tha se po të kishte shkuar po të kishte shkuar ai plan pastaj ishte dashur me ia revokuar lejen ku kishte me qenë dëm për të pasi që ai veç kishte bërë investime, për shkak të mos informimit që nuk i ka të gjitha kushtet ndërtimore të cilat i ka shtuar drejtoria e kaluar, dhe gjatë këtij viti, pra dua të them se janë duke u digitalizuar të gjithat dhe jemi duke u përpjekur që të mos bëjmë gabime.

Ai në mes tjerash tha se nuk e di sa prej jush keni pas punë me GIS-n, është një program që ta mundëson krejt shtresat e ndryshme, me i pas të vendosura të gjitha, ty pastaj nuk mundet me të ik asnjë informatë, ta zëmë na kemi me pas një shtresë me kushtet që i lëshojmë dhe çdo ditë ato kanë me u bë update.

Sami Boroci - shtroi pyetje se a ka me pas ndonjë rol arkitekti i qytetit, në hartimin e planeve rregullative, kjo po më intereson, qysh është menduar kjo pjesë.

Arbër Sadiku - A të ka ra me lexuar dosjen e tenderit.

Ku në vazhdim duke iu përgjigjur z. Boroci tha se nëse e lexon ata, aty janë të precizuara, po gjithmonë nëpër dosje nuk është që precizohen bash m[detaje, por veç të jasin hapësirë se çka mundesh me punuar me të. Arkitekti i qytetit ka me qenë një zyrë, e cila ka me qenë në shërbim të çfarë do lloj nevoje që lidhet me planifikim, me inxhinieri etj. Kështu që absolut nuk përjashtohet mundësia për me u angazhuar edhe për shërbime të tillë.

Arianit Beqiri - tha se meqë me datën 24 e kemi seancën, a mundem me ditë përafërsisht se kur mundemi me e pas qoftë draftin e parë qoftë edhe mbase të kalon në kuvend, sepse ju edhe paskeni pasur takim me disa banorë që thonë se a po votohet plani i vjetër, por ka shumë kërkesa të mëdha duke e ditë se në mbledhjen kur është diskutuar në prill, ju është thënë banorëve që do të kryhet kjo punë brenda këtij viti, kështu që a mundeni për afërsisht me e dit për sa kohë kryhet.

Arbër Sadiku - duke iu përgjigjur z. Beqiri tha se po e kemi diskutuar shpesh se ka qenë një prej kërkesave edhe kur jemi takuar me asociacionin e arkitektëve ku disa prej anëtarëve të asociacionit kanë kërkuar të ngrihen proceset e dhënies së lejeve ndërtimore deri sa të bëhen planet e reja. Mirëpo ne ju shpjeguar që një mundësi e tillë nuk ekziston sepse nuk është kompetencë e komunës sepse ajo aludojke në mënyrën se si e ka ngrirë dhënien e lejeve ndërtimore Tirana dy herë i ka bërë. Njëherë në 2008 mos gabofsha deri në 2012 e bë Kuvendi Republikan me ligj të veçantë sepse vetëm ata mund të sjellin Vendime të tillë këtu, ne nuk kemi kompetencë dikush i cili vjen me kërkesë të një plani në fuqi e që në këtë rast Kalabria e vjetër është në fuqi ne nuk kemi të drejt të ja refuzojmë dikujt kërkesën. Megjithatë ne jemi duke u treguar shumë të vëmendshëm që këto vizionet që i kemi ne me i mbajt pak si me thënë pending për aq sa mundemi jo fshehtë me palën por duke i treguar që mos nxito sepse kjo mund të transformohet dhe bëhet edhe në të mirën tënde në qoftë se bëhet ky transformim. Por në qoftë se pala insiston me e gëzuar të drejtën e vet me planin ekzistues ne e kemi për detyrë me ja

dhënë atë mundësi, me sa unë e di tash mund ta shoh saktë për një jam i sigurte por mos gabofsha edhe një tjetër janë nja dy leje që janë lëshuar në Kalabri.

Arianit Beqiri - shtroi pyetje se a është shumë në kundërshti prej planit që është sepse nëse është ka të drejtë për ndërtim dhe është koeficienti ta zëmë 2 dhe në planin tjetër kur të vjen mund të jetë koeficienti 4 ky është muhabet tjetër por nëse në plan thotë se aty është paraparë të jetë një çerdhe, ambulantë çka do qoftë njëri ose i dyti cilido qoftë këta të dy kanë marr leje për ndërtim kjo po më intereson mua ta di.

Ai në vazhdim shtroi pyetje Plani i vjetër që është në fuqi dhe këta që kanë marr leje prej prillit deri tanë a është në kundërshtim kaq larg do me thënë nëse plani thotë çerdhe ky ka ndërtim apo është ndërtim.

Arbër Sadiku - tha se ne nuk e dimë çka thotë plani sepse ky komisioni që po krijohet është vec për ta iniciuar hartimin e planit, ne më herët folëm kundërshtimi me planin i cili është aprovuar dhe që është shfuqizuar në raport me planin që është ekzistues nuk e di a jam i qartë apo jo. Ndërsa në planin e hollësishëm që ne po mendojmë ta hartojmë në atë zonë ne nuk e kemi të qartë pa ju përbajt lejeve të cilat i kemi lëshuar, apo që janë lëshuar më herët ose që i kemi lëshuar ne ndërkokë sepse baza për të hartuar një plan se edhe ligji për planifikim e thotë baza për të hartuar planin e ri janë niveli i implementimit të planeve ekzistuese.

Ai mes tjerash tha se më e mira kishte me qenë që në një Power Point me i qit sendet aty dhe me i pa sepse aq lehtë shpjegohen se ku po marrim parcelën këndej në të djathtë, qe në të majtë një me një 5m po i marrim.

Pika e tretë

Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës

Amir Simnica - tha se kur jemi këtu tek Plani Zhvillimor edhe tek Plani rregullues Kalabria kuptohet që brenda seancës janë folur edhe afate kohore d.m.th. janë interpretuar nëpërmjet Kryetarit dhe disa asamblistë që kanë folur që kjo harta zonale na i merr 6 muaj prej këtij momenti deri në vitin e ri do të dalim me Planin e ri Zhvillimor Komunal.

Mimoza Sylejmani – lidhur me diskutimin e z. Simnica tha se as Kryetari, e as ne drejtorët deri sa e kemi kap në dorë dhe me e shpjeguar këtë GIS që po e dika edhe Rozafa nuk e kemi ditë që të merr kaq shumë kohë për ti shti në data bazë dhe me u konsultuar me institutin, me Ministrinë e Kulturës pjesën e trashëgimisë jemi në diskutime mund të them në baza ditore me Edonën që është drejtoresh aty na i ka dërguar në GIS që na ka shpëtuar sepse nuk kemi mundur prej fillimit çka ka bërë Ministria. Kemi grup punues edhe me UNDP dhe me Ministrinë ku ka përfunduar zona e vjetër dhe pjesa e trashëgimisë që është duke e organizuar Ministria por edhe Komuna është e involvuar natyrisht aty dhe ka prej krejt departamenteve grup punues. Do me thënë ata na kanë thënë që në fund të dhjetorit a është Arbër kështu UNDP maksimumi fillim të janarit që është një lehtësim për neve sepse p.sh ka pasur kufizime të hatashme.

Arbër Sadiku - tha se ata janë duke e bërë planin e menaxhimit të zonës historike që do të përfshijë edhe një hartë ku për secilën ndertës ka me qenë një kartanë që tregon cilat janë atributet e asaj ndërtese dhe çka guxon të bëhet rrith saj dhe në të.

Amir Simnica - duke u ndërlidhur në diskutim tha se e kemi pasur ne këtë telashe e kemi përjetuar në lagjen e Muhaxhirëve që e gjetëm vendin për çerdhe dhe mandej Ministria e Kulturës na tregoj që shkaku i varrezave lartë që janë përmbi përmendore që është ai qoshi aty tek marketi saktë vendi adekuatë tha jo nuk guxoni të bëni çerdhe.

Mimoza Sylejmani - tha se atë draft dokumentin të cilin jemi duke e përgatitur ndoshta javën tjetër shkon në Ministri të Planifikimit për të ju ardhur juve në Kuvend për ta qituri në shqyrtim publik, dhe kanë të drejtë të gjithë qytetarët e Prishtinës të jatin komentet e tyre. Për momentin jemi duke i marr sot komentet e drejtoreve të cilët kanë qenë në grup punues do me thënë gjithkush e ka shpjeguar vizionin e vet ndoshta për të ja u shpjeguar çka është sepse u keqkuptua Plani Zhvillimor Komunal. Ai nuk përcakton koeficient të ndërtimit, ai është vetëm zhvillim ndoshta Arbëri kështu në mënyrë pedagogjike dhe si profesor që është ja u shpjegon pak më mirë se unë edhe në pika të shkurta Arbëri nëse mundesh me ju shpjeguar më thjeshtë sepse nuk është ai që kem menduar edhe unë, edhe ti edhe krejt në të kaluarën.

Arbër Sadiku - lidhur me Planin Zhvillimor Urban tha se Plan Zhvillimor Komunal është dokument strategjik i cili i përcakton vijat e përgjithshme të zhvillimit të një qyteti lidhet shumë me urbanizëm tek ne sepse nuk do me thënë aq shumë ka aty impakt ekonomia, industria, klima e çka mos edhe pastaj ajo veç manifestohet në struktura urbane. Baza për me mundur me e përcaktuar një zhvillim është demografia gjë që në këtë pikë kemi goxha problem me Ministrinë e Planifikimit jo pse ata duan të bëjnë problem po për shkak se përfat të keq në ligj shkruan që bazë për projeksionin e të ardhmes është ky regjistrimi i popullsisë e ne regjistrimin e popullsisë e kemi të 2011-ës. Ku Prishtina i ka 198 mijë e diçka banorë edhe ata thonë ne po e dimë që Prishtina është rritë, po e dimë që Prishtina është duke shkuar duke u zgjeruar por ligji nuk na lejon që ne me parapa zgjerim të kufijve sepse këtë pikë e prek kjo është që njerëzit janë pak të interesuar dhe e barazojnë krejt me urbanizmin sepse zgjerimin e kufijve e prek Plani Zhvillimor Komunal. Do me thënë deri ku zhvillohet një pjesë urbane përcaktohet me Plan Zhvillimor Komunal.

Ai në vazhdim tha se Plani Zhvillimor Komunal në këto terma të menaxhimit të tokës e definon tokën urbane prej tokës bujqësore deri ku guxon të zhvillohet një qytet por krejt këto zhvillime ti duhet ti bazosh mbi bazën e demografisë e këtu është një po mendoj në dy-tri takimet e fundit që i kemi pasur me Ministrinë e Planifikimit ata goxha janë zbutur që mirë regjistrimi është sendi më i mirë po ta kishim pasur ne regjistrimin e 2021-ës se kemi pasur ta bëjmë me ligj.

Ai mes tjerash tha se Plani Zhvillimor Komunal është dokumenti i parë ku polla e madhe ku ti i definon strategjitetë të cilat mandej i derivojnë planet e niveleve më të ulëta që i bie me qenë harta zonale dhe planet zhvillimor i hollësishëm.

Sami Boroci - duke iu drejtuar drejtorit të Urbanizmit z. Sadiku tha se drejtor po të kuptoj se ti je profesionist je shumë pak politik edhe ndoshta nganjëherë mund të duken banale reagimet e

asamblistëve, mirëpo arsyeva është se ata nuk kanë informatë të mjaftueshme për procesin që ti po e shpjegon.

Ai në vazhdim tha se prej kur ke ardhur nuk të kam dëgjuar që e ke marr fjalën për ta shpjeguar këtë çështje unë të kisha inkurajuar ta shpjegosh po ta them kështu shumë sinqerisht se pernime secili ka nevojë. Sendi tjetër u bë pak precedent a nuk po di si ta quaj p.sh Genc Bashota ka premtuar dy vjet para se ti kryhet mandati që do ta sjellë Hartën Zonale në atë kohë dhe LDK-ja i pat barikaduar dhe nuk e votonte asnjë plan rregullativ se thonje po e presim Hartën Zonale pse nuk është duke u bërë asnjë Plan Rregullativ pa Hartën Zonale dhe tash nuk po dua të kthehem në të kaluarën.

Ai mes tjerash tha se kanë qenë praktika që janë bërë në të kaluarën dhe tash normalisht edhe unë që vij prej legjislaturave të kaluara çka është problemi me Hartë Zonale dhe Plani Zhvillimor Komunal që ka ardhur në fund të mandatit të kaluar nuk e kemi votuar.

Arianit Beqiri – lidhur me Planin Zhvillimor komunal shtroi pyetje se a mundemi me ditë përafërsisht kur mundet me pas komuna draftin e parë ose nuk po e din qysh shkojnë procedurat, përafërsisht kur mundemi me fole se është bërë një vit qeverisje, mos me na ndodhë prapë sikur herën e kaluar që në fund të mandatit ose kurdo qoftë mbase edhe nga mesi i mandatit me na ardhur një planë i tillë për shkak se është shume i rëndësishëm për krejt komunën, kjo është e para.

E dyta kisha pas qejf me ditë nëse është aktualisht një grup me i gjallë duke punua në të, a është grup vetëm i komunës qe janë vetëm drejtoret a po ka edhe grup tjetër jashtë. Unë i dëgjova testi i UNDP-së apo çka do qofte por kush është, a ka njerëz te cilët janë duke kontribuar ne këtë plane zhvillimor.

Dhe e treta për punën e koeficientit, drejtor ne si asamblistë sigurisht qe kemi me pyet dhe kemi me fol për punën e koeficientit për shkak se koeficientin se kanë caktuar askush prej opozitës. Nuk po them qe koeficientin e cakton as ju mbase si drejtorë as kryetari, por dikush qe ka me e zgjedh komuna dhe ekzekutivi, qeta kane me caktua koeficientin.

Arbër Sadiku: duke iu përgjigjur z. Beqiri tha se jo Arianit, në qoftë se bëhet veç me 51. Nuk po e them unë atë që mua po më pengon qe po interesoheni, por po interesoheni në kohën kur s'kemi përgjigje se kur të bëhen hartat zonale normalisht qe kemi me fol për koeficientet se ajo është koha kur qaty parashihen.

Ku ai në vazhdim tha se nuk vinë këto pyetje vetëm prej asamblistëve, vinë edhe prej vetë drejtorëve, vinë edhe prej kafeve edhe ne u lodhëm duke ua sshpjeguar që ky dokument nuk i përcakton ato sepse absolutisht nuk ka send më me interes se për një pronar të tokës me ditë se me tokën e vet çka ka me u bo.

Mimoza Sylejmani- duke u përgjigjur në pyetjen e z. Beqiri tha se po Arianit, ne po besojmë jemi duke i pritur komentet vetëm na kanë mbetur UN dhe HABITATIT, të fundit komentet d.m.th që i ka dërguar është asociacioni i arkitekteve në ora 16.27, po e shikoj jemi duke e inkorporuar dokumentin të cilin javë kemi dërguar atyre dhe ato po besoj që javën tjetër janë te gatshme.

Për momentin që ato i kemi të gatshëm kemi me e mbajtur edhe një dite javën e ardhshme me grupin punues të drejtoreve, që është kemi me i diskutuar kemi me ju treguar se edhe ata i kanë pyetjet po sikur edhe ju nuk kanë faj se janë të profesioneve të ndryshme kemi me i inkorporuar të

gjitha komentet që i kanë dërguar deri me ditën e sotme dhe me thanë deri para një ore e gjysme edhe kemi me e dërguar në Ministri qysh thotë ligji.

Ministria momentin që na thotë ju jeni OK, dorëzoni na jep një letër që na duhet me e pruar në Kuvend, e bimë për shqyrtim publik ne Kuvend dhe ju prezantohet qysh tha Arbëri një prezantim për me e kupuar edhe tjerët ka me u bërë me Power Point,. Mirëpo Dokumenti ka me ju ardhur me CD-ja ose USB-ja, është dokument i madhe të cilin nuk e përballojnë emailat tonë që i kemi se e kam provuar me e dërguar tash së është diku prej 300 e diçka faqeve, d.m.th unë Arbëri dhe kryetari jemi më të lumtur me përfunduar sa me shpejt që është e mundur.

Po ashtu edhe ministri se Prishtina është kryeqyteti edhe sa ma shpejt të jetë e mundur po mundohemi me dal një dokument sa me i mirë me sinqueritetin më të madhë po ju them kemi me punuar me Arbërinë me të gjithë grupin që dokumenti mos me përbajte gjera qysh kanë përmbyllur këtë mbajte deri tash edhe kompania edhe krejt.

Pika e katërt

Të ndryshme

Amir Simnica - nëse nuk ka askush të thotë diçka tjeter atëherë e konsideroj të mbyllur këtë takim shihemi në takimin e ardhshëm.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija



Kryesuesi i Komitetit
Amir Simnica

Faqe 8 nga 8